



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjiçan
Gilan Belediyesi

Në bazë të nenit 11, paragrafi 1, 2, nënparagrafi 2.1, 2.2 dhe 2.3, paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit nr.04/L-144 Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i dt.22 Nëntor 2012, nenit 38, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 i Statutit të Komunës së Gjiçanit, pas Pëlqimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, nr.172 të dt.15.05.2013, me qëllim të implementimit të Strategjisë Kosovare për Rini 2011-2017, si dhe me Rekomandimin e Komitetit për Pronë, Banim dhe Rindërtim të dt.29.05.2013, për këmbimin e pronës komunale me pronën e MPMS, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në seancën e mbajtur me date 27.06.2013 miraton këtë :

V E N D I M

Për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme të MPMS , Zona Kadastrale Gjiçan

I.

Me këtë Vendim, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit **Aprovon propozimin e Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës komunale me pronën e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale – Entit për Punësim, Zona Kadastrale Gjiçan.**

II.

Lejohet këmbimi i ngastrës kadastrale P-70403013-00001-11, lloji i njësisë – parcelë, zona-urbane, me sipërfaqe prej 4000 m², vendi i quajtur “Gllama, lloji i shfrytëzimit të parcelës- tokë tjetër, shfrytëzimi aktual i parcelës- tokë jopjellore, e cila evidentohet në emër të pronarit P.Sh. Kuvendi Komunës –Gjiçan, si dhe ngastra kadastrale P-70403013-00001-12, lloji i pronës – parcelë, zona – urbane, me sipërfaqe prej 1000 m², lloji i shfrytëzimit- tokë tjetër, shfrytëzimi aktual i parcelës - tokë jopjellore e cila evidentohet në emër të pronarit P.Sh. Kuvendi i Komunës Gjiçan. Sipërfaqja e përgjithshme e këtyre dy ngastrave është 5000 m² dhe të njejtat i janë dhënë në shfrytëzim për kohë të pacaktuar Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me Vendimin e Kuvendit Komunal të Gjiçanit 01.Nr.16/5683 i dt.27.04.2011.

III.

Ngastrat kadastrale të përshkruara në nenin II të këtij Vendimi të këmbehen me ngastrën kadastrale P-70403013-02433-0, lloji i njësisë- parcelë, lloji i pronës- shoqërore, zona- urbane, me sipërfaqe prej 4539 m² e cila evidentohet në emër të P.Sh. Enti për Punësim- Gjiçan. Pjesa e kësaj parcele në sipërfaqe prej 700 m² do t'i dedikohet Drejtorisë Komunale për Kulturë, Rini dhe Sport për ndërtimin e Qendrës Rinore me anë të së cilës kjo Drejtori do t'i realizonte kompetencat e veta në përputhje me Strategjinë Kosovare për Rini 2013-2017.

IV.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjiçanit, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e KK-Gjiçan, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjiçan.

V.

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhën zyrtare në web faqen e Komunës.

Nr.01. 16-59048
Gjiçan, më 27.06.2013

Kuvendi i Komunës,

Izmi ZEKA, Kryesues